



- Ulliam Shekspir e ngriti artin poetik në majat më të larta. Kur flitet për Shekspirin, fare pak emra i qendrojnë përkrah dhe asnjë përsipër. Studimet, analizat dhe komentet reth tij janë të panumërta dhe të gjithë bien dakort në një pikë: vepra shekspiriane është e admirueshme si tërësi dhe në tërë përbërsit e veqantë. Nuk ka aktor që nuk do të dëshironte të luante në një pjesë të tij.



- **William Shakespeare** (sq. *Uiliam Shejkspir*) është dramaturgu më i njohur anglez lindi në Stratford mbi Avon më 23 prill të vitit 1564 vdiq më 23 prill 1616.
- Uiliami ishte fëmija i tretë i John dhe Mary Shakespeare. Nga tetë fëmijët e tyre mbijetuan katër, dy prej të cilëve u bënë aktorë: Uiliami dhe vëllai i tij më i vogël Edmund i lindur më 1580, i cili shkoi me të në Londër.



■ Ulliam Shekspir u martua në moshën 18-vjeqare me Ana Herthuejn, disa vjet më e madhe se ai, sigurisht që e ka penguar të vazhdojë studimet universitare, megjithëse disa biografë pohojne se ai ka mundur të ndjekë mësimet në Oksford gjatë një ose dy semestrash. Me të shoqen ai do të kishte tre fëmijë: një djalë, me emrin Hamnet, që do ta pikëllonte me vdekjen në moshën e njomë njëmbëdhjetëvjeqare, dhe dy vajza, Suzana dhe Judita, të cilat i donte shumë.



- Rreth moshës 22 vjeq, Ulliam Shekspir largohet përfundimisht nga familja dhe vendoset në Londër. Mendohet se vitet e para të qëndrimit në Londër ai u bashkua me ndonjë trupë aktorësh shëtitës, por asnjë dokumentim të saktë nuk ka për këtë periudhë.
- Mirpo më 1592 del se ermi i Shekspirit njëhej në Londër, qoftë si autor dramatik, qoftë si aktor



- Vepra e tij e parë **Henriku VI**, u shfaq po këtë vit, ndërkohë që autori i ri pëmendet nga bashkëkohësit me nofkën “shake-scene” (“skenë tundësi”), që iu ngjiti sipas emrit të vet Shakespeare
- Në sajë të mbështetjes së kontin Sauthemton, Shekspiri mundi të përparojë shpejt në mjedisin londinez. Më 1597 ai ka shruar veprat e para dhe është bërë bashkëthemelues i teatrit “Globus”. Në këtë teatër do të luhen pjesët e tij të mëdha, kurse ai vetë do të jetë aktor.



- Trupa e teatrit merrej nën mbrojtje nga mecenë të fuqishëm, lordë e shambellanë, e më pas nga vetë mbreti Xhejms, që erdhi në fron mbas vdekjes së mbretëreshës Elizabetë. Deri më 1612, kur Shekspiri vendos ta lërë Londrën e të tërhiqet në Straford, ku me 1597 ka blerë një shtëpi të bukur sa edhe vet veprimtaria e tij skenike. Më 1616 Sheksipri përpilon testamentin e vet dhe vdes një muaj mbrapa, në datën që ka lindur, 23 prill, dhe varroset në kishën e vendlindjes.




- Shekspiri konsiderohet si shkrimtari më i shkëlqyer i gjuhës angleze, në mënyrë absolute, një ndër shkrimtarët më të mëdhenj të të gjitha kohërave. Ai ka qenë komediograf, dramaturg, por edhe aktor. Ai jo vetëm që shkroi disa tragjedi të jashtëzakonshme të cilat hynë në historinë e letërsisë botërore, por edhe shumë komedi dëfyese që nuk u shfaqen kurrë nëpër skenat angleze.



- Në një qerek shekulli krijmatri, Shekspiri realizoi një vepër të mahnitshme, shumë të larmishme e të bollshme. Gjithsej 37 vepra për teatrin, nga te cilat 13 tragjedi, 10 drama historike, 14 komedi. Nuk mbetet aspak mbrapa pjesa e tjetër e krijmtarisë, ku bëjnë pjesë 154 sonete, të vlerësuara si realizimi poetik më i qmueshëm i gjithë periudhës elizabetiane , 2 poema të gjata, secila një perlë në llojin e vet, si dhe poezi të rastit



- Karakteristika që e bëri Shekspirin të mbahet si poet i lartë dramatik, ishte se ai përdori kryesisht vargun-komedi, drame, tragjedi.



- Prodhimi dramatik i Shekspirit njih katër periudha kryesore.
- Në periudhën e rinisë (1588-1595) mbizotrojnë dramet historike dhe komeditë. Një ndër titujt më të njohur janë pjesa **Rikardi III**, komedite *Zhytja e kryeneqes* dhe *Endrra e nje nate vere*, tragjedia *Romeo dhe Zhuljeta*.
- Periudha e pjekurise (1595-1602) mbahet si peridha e komedive të mëdha, të tilla si *Shumë zhurmë për asgjë*, *Si të doni ju*, *Nata e dymbëdhjetë*.
- Periudha e pesimizmit (1602-1610) dhe përkon me krijim e tragjedive të mëdha , që pëbëjnë kurorën e qmueshme të teatrit shekspirian: *Hamlet*, *Makbeth*, *Otello*, *Mbreti Lir*.
- Dhe periudha e pajtimit me veten: I tërhequr në pronat e tij në vendlindje, dramaturgu i madh shkruan pjesët e njohuara si tagjikomedi, ku elementi fantastik-alegorik bëhet mbizotrues dhe pesimizmi bashkohet me poezinë më të lartë.



- Komeditë e Shekspirit ndahen në dy kategori , në komedi *satirike* dhe *problemore* nga njëra anë dhe në komedi *romaneske* dhe *fantastike* nga ana tjetër.
- Në llojin e parë hyjnë komeditë ku pëqeshen anë të ndryshme të karakterit dhe të shoqërisë njerzore, si për shembull tek *Zbutja e kryeneqes*. Kurse komedia problemore *Masë për masë* ndërthur intrigën e dashurisë me problemin e abuzimit me pushtetin.



- Grupimin tjetër dhe më të rëndësishëm e përbëjnë tragjeditë mbretrore, ku dallohen Hamleti, Makbethi dhe Mreti Lir. Ketu konflikti tragjik lind si pasojë e një krimi, të cilin Shekspiri e përcakton si më të tmerrshmin, e ky është krimi i uzurpimit të pushtetit, ose vrasja e mbretit.